



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
BORDI

VENDIM

Nr. 40, Datë 07.03.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E “UDHËZUESIT PËR  
MONITORIMIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16, 22, 51 dhe 97 pika 4 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.519 datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike; nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.03.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi fillimin e procedurave për miratimin e “Udhëzuesit për monitorimin e tregut të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Gjatë vitit 2018 me asistencën dhe konsulencën e USAID/RTI, është punuar dhe hartuar udhëzuesi për monitorimin e tregut të energjisë elektrike, në mbështetje të detyrimeve të ERE-s për monitorimin e tregut të energjisë, që lindin nga Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë” i ndryshuar, si dhe aktet e tjera për këtë qëllim.
- Ky udhëzues është i organizuar në kapituj dhe seksione që përshkruajnë:
  1. Një vështrim të përgjithshëm për vendosjen e funksioneve të monitorimit të tregut nga ERE dhe hapat e nevojshëm për t’u ndërmarrë në procesin e zhvillimit të funksioneve të monitorimit të tregut.
  2. Rolet e pjesëmarrësve të tregtu me qëllim monitorimin e tregut, të caktuara nga ERE sipas legjislacionit përkatës në Shqipëri, Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike” i ndryshuar, Rregullat e Tregut, si dhe legjislacioni në rajon në kontekstin e kërkesave dhe pranimeve të Bashkimit Evropian (BE).
  3. Parimet që duhet të përshtaten për monitorimin e tregut.
  4. Udhëzime për zbatimin e përgjegjësive të monitorimit të tregut, të tilla si mjetet për identifikimin e sjelljeve që nuk janë në përputhje me parimet e konkurrencës dhe identifikimin e manipulimeve të çmimeve.

6. Aspektet e zbatimit në lidhje me monitorimin të tregut, përfshirë proceset e nevojshme për t'u zbatuar, kërkesat rregullatore të vendosura mbi pjesëmarrësit e tregut, organizimi i brendshëm dhe strukturimi i funksionit të monitorimit të tregut brenda ERE-s dhe rregullat për zbatimin e kërkesave.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për miratimin e “Udhëzuesit për monitorimin e tregut të energjisë elektrike” .
2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë palët e interesit, Autoritetin e Konkurrencës, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, në lidhje me këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM  
ANËTARE E BORDIT  
Erjola SADUSHI**